



Pranuar / Doretuar Punëjona / Prodato Received / Delivered	26.04	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Puteq Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMSTOK	2004/2021		1/4	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.138/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.138/2021 të datës 15.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Hasan Prishtina", Nr.62, në Komunën e Gjilanit, në çështjen juridike "kompenzim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.04.2021, mori këtë:

### V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.138/2021 e datës 15.03.2021 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Komunën e Gjilanit sipas Akt emërimit me numër Nr.02/016-17016 të datës 14.02.2019 në pozitën e punës "Inspektor i Tregut", në Sektorin e Tregut, Drejtoria për Inspeksion, për muajin mars dhe prill të vitit 2020 në përputhje me Vendimin Nr.31-2/2020, të datës 27.04.2020 ka realizuar shtesë në të ardhura personale në vlerë prej 300 (treqind euro) për punën gjatë situatës me pandeminë Covid 19, ndërsa që nga muaji maj i vitit 2020 e deri me datën e parashtrimit të ankesës nuk ka pranuar shtesë në të ardhura personale për punën gjatë situatës me pandeminë Covid 19.

Ankuesi i pakënaqur me mos realizimin e shtesave nga pakoja emergjente COVID-19, me datë 15.03.2021 ka parashtruar ankesë me Nr.Prot:1131/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim material nga pakoja emergjente COVID-19 nga muaji maj 2020 e deri në parashtrimin e ankesës, sipas vendimit të Qeveris së Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Gjilanit, ndërsa me datë 02.04.2021 Komuna e Gjilanit ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1131/2021 të datës 15.03.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emali zyrtar i datës 10.03.2021; Kërkesën e datës 02.03.2021; Vendimin Nr.06/58, i datës 14.01.2021 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/51, i datës 22.12.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/42, i datës 11.11.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/41, i datës 06.11.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës për mbrojtjen nga pandemia COVID-19; Vendimin Nr.01/39, i datës 01.11.2021 i Qeveris së Republikës së Kosovës për masat e veçanta për mbrojtjen nga pandemia COVID-19; Vendimi Nr.01/32, i datës 25.09.2020, për aprovimin e kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimin Nr.02/32, i datës 25.09.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/23, i datës 13.08.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/21, i datës 07.08.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.02/21, i datës 07.08.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.05/18, i datës 29.07.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/17, i datës 28.07.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/13, i datës 13.07.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.02/13, i datës 13.07.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.04/13, i datës 13.07.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/10, i datës 05.07.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.02/08, i datës 23.06.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.02/06, i datës 17.06.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/04, i datës 07.06.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.02/33, i datës 19.05.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/24, i datës 08.04.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/22, i datës 05.04.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/19, i datës 30.03.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/15, i datës 23.03.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/11, i datës 15.03.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.01/09, i datës 13.03.2020 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.08/85, i datës 18.02.2021 i Qeveris së Republikës së Kosovës; Kërkesa për përgjigje e datës 17.03.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 02.04.2021; Vendimi Nr.31-2/2020, i datës 27.04.2020 i Ministrisë së Financave dhe Transfereve; Akt emërimi i ankuesit i datës 14.02.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin e ankuesit i cili pretendon se institucioni nuk i ka kompensuar shtesën në të ardhura personale për punën gjatë situatës me pandeminë Covid 19, që nga muaji maj 2020 edhe pse sipas ankuesit ai ka qenë drejtpërdrejt i rrezikuar nga virusi COVID -19 gjatë punës si Inspektor i Tregut mirëpo ai nuk ka marr mjete shtesë sikurse personeli mjekësor, policia e Kosovës,


zjarrfikësit, arsimtarët konform nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID - 19, prandaj ai kërkon që ti kompensohen mjetet shtesë në bazë të legjislacionit në fuqi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit dhe dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit ka konstatuar që ankuesi shtesën në të ardhura personale në vlerë prej 300 (treqind euro) për punën gjatë situatës me pandeminë Covid 19, për muajt mars dhe prill 2020 e ka përfituar duke u mbështetur në Vendimin Nr.31-2/2020, të datës 27.04.2020, të Qeverisë në detyrë të Republikës së Kosovës ku në masën Masa 6, është përcaktuar se: *“Sigurimi i shtesës mbi pagën bazë në vlerë prej treqind (300) euro për punëtorët në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punën e tyre (jo i gjithë stafi i institucionit): ...zyrtarët (inspektorët) e Inspektoratit të Tregut, ... , për muajin Prill dhe Maj deri në vlerën prej pesëmbëdhjete milion (15,000,000,00 )euro”,* rrjedhimisht në bazë të listës së pagave Kolegji konstaton se ankuesi e ka realizuar të drejtën e tij për shtesë mbi pagën bazë sipas vendimit të lartcekur, në muajin prill dhe maj për muajt mars dhe prill, andaj Kolegji konstaton se ankuesi nuk mund ta realizoj këtë të drejtë ex officio duke u mbështetur në nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID - 19, pasi që edhe në Vendimin Nr.31-2/2020, të datës 27.04.2020, me të cilin është aprovuar Plani Operacional për Pakon Fiskale Emergjente, ku në masën 6 përfshihet „sigurimi i shtesës mbi page në vlerë prej treqind (300) euro për punëtorët në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punën e tyre ( jo i gjithë stafi i institucionit“), ndërsa në masën 6 pika 1 është përcaktuar se *„jo i gjithë stafi i institucioneve i listuar në këtë masë do të përfitojnë nga kjo shtesë prej 300 euro meqë ajo është e kufizuar në dy kushte 1.puna në terren dhe 2.ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj rrezikut të infektimit për shkak të punës së bere. Stafi i cili nuk i ka përmbush këto kushte(stafi administrativ, stafi i liruar, stafi në pushim dhe kategoritë e ngjashme) nuk mund të përfitojnë nga kjo masë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtesa në të ardhura personale për punën gjatë situatës me pandeminë Covid 19, konstaton kjo shtesë i është njohur vetëm atyre personave që kanë qenë drejtpërdrejtë të rrezikuar nga infektimi me COVID-19, respektivisht zyrtarëve aktiv në terren dhe se ankuesi po ashtu ka dështuar që ta dëshmojë me ndonjë provë apo ta argumentoj me ndonjë dëshmi se atij i është shkelur e drejta në kompensimin që e kërkon.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pozita e ankuesit nuk është e përfshirë në pakon emergjente dhe se ai nuk mund të realizoj shtesën e pretenduar, ndërsa ankuesi po ashtu edhe institucioni nuk kanë ofruar asnjë dëshmi me të cilin dëshmohet se ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit siç pretendon.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.186/2021**

**Hysni Mustafa**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

